



**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosovo - Republic of Kosovo**  
*Kuvendi - Skupština - Assembly*

---

**LEGJISLATURA V**

**Sesioni pranveror**

**Komisioni për Integritet Evropian**

**Mbledhja nr. 65**

**Prishtinë, më 24.01.2017, në orën 11:00**

**Ndërtesa e Kuvendit, N-302**

**PROCESVERBAL**

**Në mbledhje morën pjesë: Njomza Emini, Vjosa Osmani, Valdete Bajrami, Arben Gashi, Fatmir Xhelili, Bislim Zogaj, Donika Kadaj-Bujupi, Time Kadrijaj dhe Kujtim Paqaku.**

**Munguan: Xhavit Haliti ( udhëtim zyrtar) dhe Slobodan Petroviq.**

**Nga Staf i Mbështetës i Komisionit: Ahtere Loxha, Adelina Demolli, Safet Beqiri dhe Florent Mehmeti.**

**Mbledhjen e kryesoi Njomza Emini, kryetare e Komisionit.**

**Në mbledhje u propozua ky:**

**Rend i ditës:**

- 1. Miratimi i rendit të ditës;**
- 2. Miratimi i procesverbaleve të mbledhjeve të mbajtura më 14.12.2016, 21.12.2016, 22.12.2014 dhe 30.12.2016.**
- 3. Miratimi i Raportit të Punës së Komisionit për vitin 2016;**
- 4. Miratimi i Planit të Punës së Komisionit për vitin 2017;**
- 5. Të ndryshme.**

**Kryetarja e Komisionit, znj. Njomza Emini, pasi konstatoi se janë plotësuar kushtet për punë e hapi mbledhjen.**

**1. Miratimi i rendit të ditës**

**Rendi i ditës u miratua pa ndryshime.**

## **2. Miratimi i procesverbaleve të mbledhjeve të mbajtura më 14.12.2016, 21.12.2016, 22.12.2014 dhe 30.12.2016**

Procesverbalet e mbledhjeve të mbajtura më 14.12.2016, 21.12.2016, 22.12.2014 dhe 30.12.2016 u miratuan pa vërejtje.

## **3. Miratimi i Raportit të Punës së Komisionit për vitin 2016**

**Kryetarja** theksoi se Raporti i Punës së Komisionit për vitin 2016 është një përmbledhje në të cilën janë pasqyruar aktivitetet që Komisioni i ka realizuar gjatë vitit 2016.

Pasi nuk u paraqitën diskutues **kryetarja** konstatoj se Komisioni miratoi Raportin e Punës së Komisionit për vitin 2016, pa ndryshime.

## **4. Miratimi i Planit të Punës së Komisionit për vitin 2017**

**Kryetarja** i njoftoi se lidhur me planin e punës së Komisionit është mbajtur një takim me shoqërinë civile me të cilët Komisioni ka pasur bashkëpunim vitin e kaluar. Ajo tha se jemi munduar bashkërisht t'i përfshijmë aktivitetet për vitin 2017.

Ky është një draft dhe me propozimet e juaja mund të plotësohet dhe ndryshohet, andaj e hap debatin.

**Fatmir Xhelili** konsideron se është praktikë që çdo dy muaj me radhë ministri në Komision me raportuar për zbatimin e aktiviteteve të realizuara nga MSA. Konsideroj se do të ishte ma e logjikshme që të vijnë të raportojnë ata të cilët teknikisht janë të lidhur me përcjelljen dhe raportimin. Në vazhdim kërkoi që të përfshihen më tepër ligje për monitorim të zbatimit të tyre, të monitorohen ato ligje të cilat janë më diskutabile, ose ato të cilat nuk janë në relacion të drejtë me ligjet e BE-së, të formohen dy grupe dhe 4 ligje, kishim mundur me i përfshirë në Plan të punës, dy gjatë një sesioni dhe dy në sesionin tjetër.

**Time Kadrija** nuk pajtohet me propozimin e parafolësit sepse tha se krijohet një praktikë e keqe dhe ministrat kanë me ikur gjithmonë për me ardhur me na raportuar. Pastaj do të na dërgojnë gjithmonë dikë nga ministria. Ministrat janë të obliguar me ardhur me raportuar para komisioneve dhe në Kuvend. Andaj konsideron se kjo nuk është praktikë e mirë.

**Fatmir Xhelili** tha se është keqkuptim, sepse tha se nuk është kundër me ardhur ministri me raportuar çdo dy muaj, por me ardhur raportuesit e sektorëve të ministrive të cilët drejtpërdrejt janë të lidhur me zbatimin e MSA-së, ose raportuesi i Qeverisë i cili raporton të kryeministri.

**Arben Gashi** tha se lidhur me MSA-në ekziston Komisioni i veçantë, por mendon se më mirë është Komisioni me pasur një raport të shkruar periodik në vazhdimësi se çka po ndodh, kurse kur i ftojme ministrat ta kemi një bazë.

**Kryetarja** tha se kishte menduar që lidhur me grupet punuese paraprakisht me biseduar me Komisionin për vizita në terren në mënyrë që të jemi më proaktivë dhe të ndahemi të realizojmë vizita nëpër komuna për me shikuar zbatimin e MSA-së.

**Arben Gashi** propozoi që të miratohet Plani i punës, sepse vlerësoi se në aspektin strategjik dhe teknik plani është i hartuar mirë, orientimisht tha i dimë për secilin muaj aktivitetet, andaj kur të afrohet koha e bëjmë konkrete secilën vizitë.

**Valdete Bajrami** konsideron se sot nuk është momenti të ndahen grupet punuese dhe të vendoset se kush do të jetë në grup, kurse sa i përket zbatimit të MSA-së, ajo tha se ne nuk duhet të bëjmë punë paralele, sepse ekziston komisioni përgjegjës për MSA-në, por çështjet që kanë

rrjedhur prej procesit detyrimisht duhet me inkorporua në planë dhe, si Komision, duhet ta kemi një rol edhe më të madh dhe duhet të jemi proaktivë sepse e kemi Ministrinë e Linjës e cila është pa ministër dhe ne, si Komision, duhet ta bëjmë një strategji që të kërkojmë që Ministria e Integriteteve, ose ta ketë ministrin, ose të shuhet si ministri.

**Fatmir Xhelili** tha se edhe unë kamë menduar që të monitorojmë dy ligje për një sesion, dy në sesionin tjetër, njëkohësisht kur vendosemi për ligje atëherë i formojmë edhe grupet punuese, kurse sa i përket Ministrisë së Integriteteve, ajo është ministri mjaft e rëndësishme dhe nuk duhet të shuhet.

**Vjosa Osmani** theksoi se në të kaluarën Komisioni e ka shqyrtuar më gjatë planin e punës, minimum një javë dhe më pas 3 deri në 4 orë e kemi shqyrtuar në takim.

Në vazhdim tha se do të ishte mirë që në Plan të punës të përfshihen edhe disa sfida nga Raporti i Progresit, me i planifikuar paraprakisht, e jo me qenë çështje ad-hoc dhe me i adresuar në nivel të vendit, që mos me mbetur vetëm me raportime te ministrave dhe pyetje parlamentare, por me e rritur rolin e Komisionit duke marrë vetë iniciativa për me i përmirësua gjërat që nuk janë në rregull, sidomos në fushën e legjislacionit

**Kujtim Paqaku**, lidhur me Planin e punës, propozoi që Komisioni një herë në muaj të bëj ndonjë aktivitet konkret për komunitetet. Ky vit tha se do të na pret me shumë sfida, do të ballafaqohemi me të riadhesuarit me fokus të madh me komunitetet RAE, do duhej të bëhej një hulumtim mbi punën e departamentit për të riadhesuarit në Ministrinë e Punëve të Brendshme dhe në qeverisjen lokale, se sa kanë siguruar buxhet për të riadhesuarit, të informohemi se sa janë integruar të riadhesuarit sepse kemi informata që qeverisja lokale ende nuk e ka të rezervuar buxhetin për të riadhesuarit dhe nga kjo del se korrespondenca mes qeverisjes qendrore dhe lokale nuk është funksionale aq sa duhet. Andaj kërkoi që të përfshihen në plan të punës aktivitetet që të shohim gjendjen momentale të riadhesuarve kosovarë.

**Fatmir Xhelili** e përkrahu propozimin e parafolësit dhe njoftoi se para 3 vjetëve është bërë mbikëqyrja e zbatimit të Ligjit për Ripranim në nivelin komunal dhe qendror dhe është ligj që bukur ka avancuar në zbatimin e tij dhe fondi i Qeverisë për ripranim gjithmonë ka ekzistuar, mirëpo do të ishte mirë me shikuar se sa është zbatuar ky ligj këto 3 vjetët e fundit, sepse ndoshta do te ndikonte në përmirësimin e kualitetit të jetës së riadhesuarave.

**Vjosa Osmani** shtoi se edhe Komisioni ynë e ka bërë monitorimin e Ligjit për ripranim para gati dy vjetësh, ka pasur vizita edhe nëpër komuna dhe është parë që ka pasur probleme në mënyrën e implementimit të disa dispozitave të ligjit, sidomos në shpenzimin e buxhetit. Buxheti ka ekzistuar madje është shumëfishuar, mirëpo nuk është shfrytëzuar, sepse rregulloret e tyre komunale gjithmonë kanë qenë pengesë, gjithmonë komuna ka pritur që dikush me ia kryer punët. Ne patëm rekomanduar që vet komuna me i vizituar të riadhesuarit në mënyrë që t'i shfrytëzojnë gjitha të drejtat dhe mos t'i humbin afatet për aplikim.

Duhet shikuar sa janë marrë parasysh rekomandimet e Komisionit tonë dhe atij për punë të brendshme dhe pastaj të shohim se sa ka nevojë edhe për ndryshime legjislative dhe me i propozua Qeverisë dhe komunave për veprime tjera me i ndërmarrë.

Pas diskutimeve kryetarja se Komisioni me shumicë votash nxori këtë:

### **Rekomandim**

**Miratohet Plani i punës së Komisionit për vitin 2017 me propozimet për plotësim.**

## **5. Të ndryshme**

**Kryetarja** për këtë pikë pyeti anëtarët se a kanë çështje për të diskutuar në Komision.

**Donika Kadaj- Bujupi** theksoi se edhe viti 2017 ka filluar me një problem i cili në vazhdimësi është kritikë në Raportin e Progresit, ajo është llogaridhënia e Qeverisë kundruall Kuvendit, e sidomos në sferën e dialogut, edhe sot ka filluar raundi i bisedimeve dhe Kuvendi është komplet i përjashtuar dhe deputetët informohen vetëm përmes mediave.

Siç jeni të njoftuar grupet e subjekteve opozitare kanë filluar një proces të nënshkrimeve që sot në orën 16- të mbahet një seancë e jashtëzakonshme. Konsideroj se në frymën e rritjes së llogaridhënies dhe transparencës së Qeverisë ndaj Kuvendit, të kemi një përkrahje të anëtarëve të këtij Komisioni. Të gjithë jemi dëshmitarë që pas nënshkrimit të marrëveshjes së gushtit të vitit 2015 gjithçka në Kosovë është bllokuar, pikërisht për shkak të nënshkrimeve të marrëveshjeve dhe një dialogu jo transparent, po ndodh agresioni i Serbisë ndaj Kosovës.

Andaj do të ishte mirë që ne, si Komision, por edhe si deputet individualisht ta përkrahim këtë iniciativë, ta nënshkruajmë dhe në orët e pasdites të mbahet një seancë e jashtëzakonshme dhe t'i thërrasim në përgjegjësi të gjithë ata që edhe kësaj here vrapuan fshehurazi pa njoftuar paraprakisht deputetët dhe Kuvendin. Andaj kisha kërkuar përkrahjen e juaj edhe si deputetë dhe si Komision ta trajtojmë këtë çështje dhe të nënshkruheni në listën që e kam me vete.

**Fatmir Xhelili** tha se Qeveria e ka autorizimin prej Kuvendit me i zhvilluar bisedimet dhe ajo i përcakton fazat për zhvillimin e bisedimeve. Bisedimet planifikohen, por ndonjëherë bëhen edhe ad-hoc sepse këtë e kemi obligim prej BE-së dhe së pari prej vetvetes, sidoqoftë nuk ka pasur ndonjë agresion ndaj Kosovës në kuptimin fizik dhe është menaxhuar mirë.

**Donika Kadaj- Bujupi** tha se agresion ma të madh se treni dhe deklaratat e presidentit të Serbisë, me të cilin sot Hashim Thaçi është ulur me biseduar, murin në Mitrovicë dhe arrestimin e z. Hajradinaj, kjo është një dhunë sistematike e cila në vazhdimësi po e nënshtron Kosovën. Nuk po e kuptoj pse do të ishte e tepërt që ky Kuvend ta ketë një seancë të jashtëzakonshme në këto rrethana të jashtëzakonshme.

Ne, si Kuvend dhe si deputetë, individualisht jemi të obliguar të veprojmë në interes të shtetit.

**Arben Gashi** mendon se tema e propozuar është e rëndësishme, por tha se janë disa probleme; E para është problemi logjistik, për derisa Kryeministri dhe Presidenti nuk janë në Kosovë. Ideja për mbajtjen e një seance të jashtëzakonshme është jo funksionale, atëherë mund të debatojmë vetëm mes vete sepse nuk kemi informacion. Jam dakord që tema është shumë delikate dhe duhet të trajtohet me kujdes, seanca duhet të planifikohet më mirë dhe atëherë kur Kryeministri mund të jetë në seancë dhe të japë përgjegjësi për veprimet dhe mos veprimet e tij, apo Qeverisë dhe Presidentit.

Mendoj se mund të kërkohet një seancë e rregullt gjatë kësaj jave, jam i gatshëm me debatuar për një temë kaq të rëndësishme, por nuk jam i gatshëm me e qitur nënshkrimin e me debatuar pa qenë palët prezent.

**Bislim Zogaj** theksoi se çdo herë kur po kërkohen mbajtja e seancave të jashtëzakonshme, gjithmonë po janë të pa suksesshme, realisht po kërkohet me debatuar, e gjithmonë synimi po është me u nxjerrë në fund rezoluta, e rezoluta të jetë shkarkimi i kryeministrit, e jo me ardhur deri te qëllimi për çka po thirret seanca dhe të shkojë në interes të Kosovës.

**Valdete Bajrami** tha se në seancën e mbajtur për z. Haradinaj është kërkuar pezullimi i dialogut, ose formati për momentin të ndërrohet, nuk e di se ku e mori z. Thaçi atë miratim që ta kalojë nivelin e bisedimeve në nivel presidencial, ose si rrjedhojë e këtyre bisedimeve kanë ndodhur arrestimet, muri, asociacioni dhe tani edhe treni për me ardhur deri në këtë pikë ta marrë primatin dhe ta drejtojë dialogun. Tani është momenti shumë kritik dhe tash duhet të debatohet, nuk është vendim i drejtë të shkosh në të njëjtën tavolinë me Nikoliqin dhe Vuçiqin, për deri sa në Francë

është i ndaluar ish- kryeministri nga ata dhe për deri sa i kemi ende edhe 1600 persona të zhdukur dhe shumë probleme të tjera. Ne jemi ata të cilët duhet të kërkojmë llogari nga z. Mustafa dhe z. Thaçi, i ka filluar z. Thaçi këto bisedime dhe po dëshiron edhe me i përmbyllur. Që nga viti 2011 kur kanë filluar bisedimet asnjë të mirë nuk ia kanë sjellë vendit, jo vetëm Mitrovica në këtë rast që është në rrezik, por e tërë Kosova. Andaj mos hezitoni dhe mendojeni edhe një herë që të kontribuoni dhe të jeni pjesë e kësaj seance të jashtëzakonshme.

**Time Kadrijaj** tha se e dimë se Kosova i ka filluar bisedimet me Serbinë për shkak të normalizimit të marrëdhënieve dhe nuk po dimë në fakt se në çfarë pozicioni ka rënë Kosova kur e dimë se Serbia i ka nxitur të gjitha luftërat në Ballkan, ndërsa e gjithë barra po i bie Kosovës dhe Serbia me këtë projekt qeveritar po e luan rolin e viktimës, kurse Kosova rolin e agresorit, në fakt prej bisedimeve nuk kemi normalizim të raporteve, por përkundrazi kemi përkeqësim. Deri më tani janë arritur shumë marrëveshje gjatë bisedimeve, por ato nuk po implementohen nga ana e Serbisë, Qeveria nuk duhet ta luajë rolin e kukullës atje, por duhet me u ndal dhe me analizua sa po zbatohen ato marrëveshje. Serbia në Kosovë po e ushtrojnë ndikimin për mes Listës Serbe, ndërsa disa deputetë që paguhen me paratë e taksapaguesve të Kosovës, dalin dhe thonë se nuk e njohin shtetin e Kosovës dhe Kryeministër e njohin Kryeministrin e Serbisë, nuk e di deri ku do të shkojmë kështu dhe pasur të gjitha këtyre ngjarjeve Kryeministri dhe Presidenti me u nënshtuar dhe me shkuar në Bruksel, prapë në bisedime është turp ajo çka po i bëjnë vendit.

Është turp që Kryeministri dhe Presidenti nuk po dinë se çka po bisedohet, nuk duhet me e gënjyer popullin, mjaft është bërë, ne së bashku duhet me debatuar me transparencë me të gjithë liderët politikë dhe me gjetur një zgjidhje, sepse asnjë të mirë nuk i kanë sjellë këto bisedime shtetit.

**Fatmir Xhelili** tha se kam menduar që po bisedojmë për pikën, drejtimi teknik, por filloj me u bë debat dhe unë isha distancuar prej debatit, por në kuptimin që ata e kanë autorizimin dhe menaxhimi i politikave ditore është shumë racionale dhe Presidenti dhe Kryeministri janë duke tentuar për një racionalitet dhe produkti final i këtyre bisedimeve ka me zgjatur, ky është proces dhe normalisht që relacionet ndonjëherë edhe ndryshojnë, por jam i bindur se produkti final i të gjitha bisedimeve ka me qenë pozitiv.

**Vjosa Osmani** theksoi se kur në vitin 2011 patën filluar bisedimet Kosovë-Serbi Kuvendi i Kosovës i ka dhënë autorizim Qeverisë së Kosovës për të marrë pjesë në një proces ku ka pas vija të kuqe, njëra prej tyre është se nuk duhet pasur dialog për çështje të brendshme, por secila marrëveshje deri më tani pa përjashtim ka pasur të bëjë me çështje të brendshme të Kosovës.

Kuvendi se ka autorizuar asnjëherë Presidentin të ketë rol udhëheqës siç po pretendohet.

Tani nuk ka qenë momenti për bisedime pas gjitha tentimeve të Serbisë për destabilizim të Kosovës dhe për deri sa ende nuk është liruar z. Haradinaj, të shkohet pa asnjë kusht dhe vetëm të ulemi dhe të trajtohem kinse të dyja shtetet paskemi kontribuar në tension, çka nuk është e vërtetë sepse kanë qenë veprime vetëm të Serbisë për destabilizim të Kosovës, nuk jam kundër debatit edhe sot sepse çdo vit kemi kritikohemi se nuk po luajmë rol të duhur, çka do të thotë se duhet të kemi ma shumë debate dhe ma shumë raportime dhe më shumë involvim të Kuvendit.

Kishte qenë më mirë që debati të mbahet nesër, sepse ndoshta kthehen kur është kryeministri dhe presidenti dhe të ballafaqohemi me deklaratat e tyre, sepse ndryshe flasin në media, e ndryshe kanë biseduar atje, ne, si deputetë, të dalim me propozime konkrete sepse mundemi me e rritur rolin e Kuvendit në këtë proces.

**Valdete Bajrami** pyeti nëse seanca mbahet nesër a do ta veni nënshkrimin?

**Arben Gashi** tha se a është kërkuar për vendim të Komisionit apo individual? Nëse është për vendim të Komisionit është jashtë fushës së Komisionit.

**Donika Kadaj- Bujupi** shtoi se është me rëndësi me zbatuar një detyrë të rëndësishme të Komisionit që është thirrja në raportim. Nënshkrimi individual apo kolektiv nuk e bënë dallimin, ta kemi një seancë që të ketë raund të ri të bisedimeve, sepse jemi ne një fazë ku po bëhet dialog pa parime, rezultatet nga bisedimet janë në dëm të Kosovës. Të shohim ku jemi dhe çka ka përfituar Kosova dhe të dalim me një rezolutë.

**Kryetarja**, në fund të diskutimeve, tha le të jetë vendim individual i anëtarëve të Komisionit se a duan të nënshkruajnë kërkesën për mbajtjen e seancës së jashtëzakonshme plenare, apo jo.

Mbledhja përfundoi në orën 12:20.

**E përgatiti:**

**Stafi mbështetës i Komisionit.**

**Kryetare e Komisionit,**

-----

**Njomza Emini**